



Breaking News:

Malësi e Madhe/I dyshuar si bashkëpunëtor për kultivimin e 2000 bimëve narkotike, arrestohet

⏏ ⏪ ⏩



03/09/2025

DVP Tiranë/Finalizohet Operacioni Policor I Koduar "Again"

DVP Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Again".

Lëvizte i armatosur me pistoletë me fishek në fole, kapet në flagrancë dhe vihet në pranga 30-vjeçari, i dënua më parë për armëmbajtje pa leje dhe për vjedhje me dhunë.

Vihet në pranga dhe shoku i tij, për moskallëzim krimi.

Sekuestrohet pistoletë me municion luftarak.

Shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruar për një shtetas që lëvizte i armatosur, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Again".

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë kanë kapur në flagrancë në rrugën "Ibrahim Rugova", shtetasin S. S., duke lëvizur me këmbë, me 1 armë zjarri pistoletë me fishek në fole, që e mbante në brez.

Në vijim të veprimeve procedurale, specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Nr. 2 arrestuan shtetasit: S. S., 30 vjeç, banues në Tiranë, me precedent të theksuar penal dhe E. T., 35 vjeç, i cili shoqëronte 30-vjeçarin.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ Policia e Shtetit/Kapet në Malin e Zi dhe arrestohet me qëllim ekstradimin në Shqipëri, një shtetas i akuzuar për kultivim të bimëve narkotike, në Lezhë

Malësi e Madhe/I dyshuar si bashkëpunëtor për kultivimin e 2000 bimëve narkotike, arrestohet ▶